



**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**  
**UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

# **BULETINI**

**I REFERATEVE TË KANDIDATËVE TË PARAQITUR NË**  
**KONKURSIN NR. Nr. 01-236 TË DATËS 01.08.2016**  
**PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK**

## **Fakulteti i Filologjisë**

1. Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët: Hyrje në shkencat e letërsisë, Teoria e letërsisë, Letërsi për fëmijë, Letërsi popullore, Folklori arbëresh dhe Kritikë letrare, (Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe).

Kandidatët:

- 1. Dr.sc. Vjolca Dibra;**
- 2. Dr. Besa Hoxha Beqir;**
- 3. Dr.sc. Labinot Berisha;**
- 4. Dr.sc. Vehbi Miftari;**
- 5. Mr.sc. Abedin Balaj.**

2.Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët: Histori e letërsisë shqiptare I dhe II-Romantizëm, Letërsi krahasimtare, Historia e letërsisë shqipe- Realizëm, (Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe).

Kandidatët:

- 1. Dr. sc. Teuta Vinca Kafexholli;**
- 2. Dr. Besa Hoxha Beqir;**
- 3. Dr.sc. Labinot Berisha;**
- 4. Dr.sc. Vehbi Miftari;**
- 5. Mr.sc. Abedin Balaj.**

3.Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët: TEFL-Leximi dhe shkrimi, Vlerësimi dhe testet, Kulturë dhe qytetërim britanik, Shoqëri amerikane, Përvoja në shkollë nga TEFL, Materialet, Vlerësimi dhe përgaditja. (Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze).

Kandidatët:

- 1. Leutrim Dervishaj;**

4.Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët:Gramatika e gjuhës gjermane I, Gramatika e gjuhës gjermane II, Morfologji, Hyrje në didaktikën e gjuhëve të huaja, Metodika dhe didaktika e gjuhës gjermane II, Seminar i didaktikës. (Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane).

Kandidatët:

- 1. Dr. Kimete Canaj;**
- 2. Sali Dula, MA;**
- 3. Ismet Smajli, MA;**

**Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren**

**Fakulteti i Filologjisë, Prizren**



**RAPORTI I KOMISIONIT RECENSUES**

**PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK**

**Lëndët:** Hyrje në shkencat e letërsisë; Teori e letërsisë; Letërsi për fëmijë; Letërsi popullore; Folklor arbëresh dhe kritikë letrare.

**Kandidatët:** dr.sc. Vjollca Dibra; dr. Besa Hoxha Beqir; dr.sc. Labinot Berisha; dr.sc. Vehbi Miftari dhe mr.sc. Abedin Balaj.

**Komisioni recensues:**

1. Kryetar: Prof. dr. Enver Mehmeti

2. Anëtar: Prof. dr. Mirlinda Krifca

3. Anëtar: Prof. asoc. dr. Shkelqim Millaku

Komisioni recensues ka kënaqësinë për të shkruar recension për staf të ri akademik në Universitetin “Ukshin Hoti” të Prizrenit, përkatësisht për Fakultetin e Filologjisë. Komisioni do të mbështet në dispozitat e Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 04/l-037, Neni 26; Statutin e UPZ-së në përgjithësi (dhe në veçanti në nenet 8, 10, 173); në Ligjin e Punës nr. 03/L-212 dhe në dosjet apo jetëshkrimet e kandidateve.

### **Neni 173 i Statutit të UPZ-së ka këto kriterë:**

1. Për titullin e profesorit asistent kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

1.1. të ketë gradën e doktorit të shkencës, (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të);

1.2. të ketë numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare si autor i parë ose korrespondent;

1.3. të ketë krijuar punime artistike ose të ketë pasur prezantime publike, kur është fjala për Fakultetin e Arteve;

1.4. të tregojë aftësi për mësimdhënie.

1.5. të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në procesin mësimor në Universitet.

2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit është për katër (4) vite.

### **Neni 8 i Statutit të UPZ-së ka këtë përmbajtje:**

Universiteti siguron dhe mbështetë barazinë gjinore. Në rastet kur kandidatët e gjinisë mashkullore dhe femërore i kanë kualifikimet dhe te arriturat profesionale te barabarta, përparësi do t'i jepet kandidates femër.

Ky raport shkruhet për titullin akademik: Profesor asistent (prof. ass.)

### **I. Të dhënat për kandidatin:**

Emri dhe mbiemri: **Vjollca Dibra**

Datëlindja dhe vendlindja: 29. 05.1976, Prishtinë.

Gradat shkencore: Studimet themelore i mbaroi në **Fakultetin e Filologjisë**, dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Prishtinë, 2008. Kandidatja, më 15.02.1999 ka pranuar mirënjohje "Studente e dalluar" nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë - për sukses të shkëlqyeshëm në studime të rregullta. Nota mesatare e studimeve 9.22, kurse e provimit të diplomës 9.50.

**Magjistër i Shkencave të Filologjisë**, Prishtinë, 2009 (nota mesatare 8.83).

**Doktor i Shkencave të Filologjisë, 06. X. 2011.** Njohja dhe barasvlerësimi i gradës shkencore nga MASHT-i, nr. 6-1088.

**Kandidatja i plotëson kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 173, të pikës 1.1.**

### **1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor për kandidaten**

**Tabela 1.**

<b>Veprimtaria shkencore e kandidatit</b>	<b>Prej fillimit të karrierës</b>	<b>Gjatë 4 vjetëve të fundit</b>
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor*	4	4
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor**	/	/
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor*	/	
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor**	/	/
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor	/	/
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	14	2
Numri i ligjëratave gojore shkencore në		

konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)		
Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor		
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja		
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	4	3
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor		
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike	3	

<b>Të dhënat për punimet e tjera:</b>
<b>VEPRA DHE STUDIME TË BOTUARA:</b>
<p>D. Vjollca: "Suvalë e përgjumur", (poezi) <i>Buzuku</i> Prishtinë, 1995</p> <p>D. Vjollca: "Minotauri" (roman), <i>Buzuku</i>, Prishtinë, 2000.</p> <p>D. Vjollca: "Përtej vetes", (poezi) <i>Buzuku</i>, Prishtinë, 2005.</p> <p>D. Vjollca: Mozaiku i jetës model i artit (Poetika e tregimeve të Anton Pashkut), Shtëpia botuese "Anton Pashku", Biblioteka: Studime, (Redaktor: Adem Gashi, Faqe: 130, Rezymeja në gjuhën angleze, CIP – Biblioteka Kombëtare dhe Universitare, <b>ISBN 978-9951-540-07-0</b>) Prishtinë, 2009.</p> <p>D. Vjollca: Heroinat e deheroizuara (Kontekstualiteti shoqëror dhe artistik i dy protagonistëve: - Studim komparativ për romanet "Nata me hënë" të Ismail Kadaresë dhe "Nderi i humbur i Katerina Blumit" të Hajnrih Bëlit), Shtëpia botuese "TOENA" Tiranë, Biblioteka: Studime, <b>ISBN 978-99943-1-792-9</b></p> <p>D. Vjollca: Percy Bysshe Shelley (studim), <a href="http://www.ina-online.net">www.ina-online.net</a></p> <p>D. Vjollca: Albanian and English Literature in Light of Comparative Reports (studim), Academic Journal of Interdisciplinary Studies <b>ISSN 2281-3993 (print) ISSN 2281-4612 (online)</b>.</p>

D. Vjollca: Kultura gjuhësore, standardi dhe dialektet, në institucionet shtetërore, publike dhe politike (studim), shkencat gjuhësore, kulturore dhe historike “Java e shkencës” 2013, ISBN 978-9951-16-057-5

**D. Vjollca: Sistemi i arsimit në Kosovën e pasluftës dhe nënshtresa e iluminizmit (studim), shkencat pedagogjike “Java e shkencës” 2014, ISBN 978-9951-16-089-6**

D. Vjollca: Paralele krahasimtare ndërmjet veprave “Nderi i humbur i Katerina Blumit” të Heinrich Böll-it dhe “Nata me hënë” të Ismail Kadaresë, (studim), revistë hulumtuese shkencore “Fakti shkencor”, **KDU 32 (05) 005 (05), janar 2015**

D. Vjollca: The Role of Education during and after Transition Period in Kosovo” (studim), Journal of Educational and Social Research ISSN 2239-987X 9print) ISSN 2240-0524 (Online).

D. Vjollca: **Macbeth the messenger between Shakespeare and Kadare;** <http://konferencat.aab-edu.net/icllc/>; 18 June 2016

**Kandidatja i plotëson kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 173, të pikës 1.2.**

## **2. Përvoja në mësimdhënie universitare**

Më 1 tetor 2011 filloi punën si profesorësh e angazhuar në Fakultetin e Edukimit, Universiteti “Hasan Prishtina”, në Prishtinë dhe më 2012 si profesorësh e angazhuar në Fakultetin e Edukimit, Universiteti “Ukshin Hoti”, në Prizren. Në Fakultetin e Filologjisë në Prizren është duke dhënë kontributin e saj që nga viti 2014. Në Fakultetin e Filologjisë në Prizren është e angazhuar që disa vite.

Më 1 mars 2016 filloi punën si ligjëruese e rregull në Kolegjin AAB, Prishtinë.

Një kohë (1995 – 1998) punoi si gazetare dhe arsimtare e gjuhës angleze.

Që nga viti 2000 deri në vitin 2008 punoi në OSBE, në Departamentin e administratës. Në qershor të vitit 2008 u angazhua në Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë.

Gjatë gjithë shkollimit ajo është marrë aktivisht me shkrime dhe ka qenë pjesëmarrëse nëpër shumë manifestime letrare ku edhe është shpërblyer me çmime. Në manifestimin poetik tradicional letrar, takimet e poeteshave shqiptare - "Vushtrria 2003" dhe "Vushtrria 2007", Vjollca u shpërblye me vendin e parë, ndërsa në manifestimin "Vushtrria 2004" asaj i takoi vendi i dytë për poezi. Në manifestimin "Mitingu i poezisë" 2006, në Gjakovë, u shpërblye me vendin e tretë. Në manifestimin "Sofra Poetike" në Drenas 2009, u shpërblye me çmimin e nderit "Ymer Elshani". Ajo u paraqit me poezitë e saj edhe në manifestimin kulturor të organizuar nga *Shoqata e Veteranëve të arsimit dhe krijuesve të Kosovës* që u mbajt në Ulqin, më 1996. Nga mesi i vitit 2009 u zgjodh zëvendës drejtoreshë në shkollën fillore "Xhemail Mustafa" në Prishtinë. Më 29 dhjetor 2011 u zgjodh zëvendës drejtoreshë në shkollën fillore "Dardania" në Prishtinë.

**Kandidatja ka disa vite përvojë punë në universitete dhe i plotëson kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 173, pika 1.4 dhe 1.5.**

## **II. Të dhënat për kandidaten**

Emri dhe mbiemri: **Besa Hoxha Beqiri**

Datëlindja dhe vendlindja: 04.02.1968, Shkup.

Gradat shkencore: Studimet themelore i mbaroi në **Fakultetin e Filologjisë**, dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Prishtinë, në vitin 1990 (nr.287); **Magjistër i Shkencave të Filologjisë**, Prishtinë, 1995; Studimet e doktoraturës i mbaron në Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë dhe ka fituar gradën shkencore – Doktor në Studime Letrare, 2015, nr.4. Njohja dhe barasvlerësimi i gradës shkencore nga MASHT-i nr.6 -1828.

Kandidatja ka doktoruar në Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë, mirëpo mbështetur në Statutin e Qendrës në fjalë, Neni 71 shkruan: “Programet e studimeve doktorate janë programe studimesh të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë **kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur**” dhe Neni 76 “...autorizohet të kryejë mësimdhënie edhe jashtë QSA, për një ngarkesë deri në 30% të ngarkesës së pedagogut me post dhe gradë shkencore ekuivalente”.

Fakulteti i Filologjisë në Prizren ka shpallur konkurs për mësimdhënës dhe nuk ka kërkuar hulumtues shkencore, prandaj kandidatja nuk e plotëson kriteret e Nenin 173, pikën 1.1 të Statutit të UPZ-së.

Mbështetur në jetëshkrimin e kandidates, e cila dëshmon se ka disa studime të botuar, si: Një histori letërsie e ndaluar – Si u përjashtuar Fishta, Konica dhe Skiroi nga Historia e letërsisë shqipe ..., Tiranë, 2016; Eshtrat e ringjalljes, Rozafa Prishtinë, 2016; Kumtesa të ndryshme: Një histori letërsie e pabotuar, Prizren, 2014; The Albanian Literature in internet, Shkodër, 2014 dhe studime te tjera. Kushtet e Statutit të UPZ-së, Nenit 173, pikën 1.2 kandidatja relativisht mirë i ka plotësuar.

Statuti i Universitetit të Prizrenit, Neni 173, pika 1.4 dhe 1.5, i cili kërkon përvojën e punës universitare, nga dosja e kandidates Besa Hoxha-Beqiri nuk ka dëshmuar dhe dëshmi se ka përvojë në mësimdhënien universitare.

Kandidatja Besa Hoxha Beqiri nuk i plotëson gjitha kushtet e parapara me Statut. **Refuzohet.**

### III. Të dhënat për kandidatin

Emri dhe mbiemri: **Labinot Berisha**

Datëlindja dhe vendlindja: 30.11.1969

Gradat shkencore: Studimet themelore i mbaroi në **Fakultetin e Filologjisë**, dega Letërsi shqipe në Prishtinë më 02.12. 1999; **Magjistër i Shkencave të Filologjisë**, Prishtinë, 2006; Doktor në Letërsi, 30. 05. 2011, Tiranë (barasvlerësimi 6/4-744).

Mbështetur në Statutin e UPZ-së, Neni 173, pika 1.1, kandidati i plotëson kriteret e parapara për këtë pikë.

#### Kontributi shkencor i kandidatit

<b>Veprimtaria shkencore e kandidatit</b>	<b>Prej fillimit të karrierës</b>	<b>Gjatë 4 vjetëve të fundit</b>
Numri i publikimeve në revistat me “impact faktor” si autor kryesor*		
Numri i publikimeve në revistat me “impact faktor” si koautor**		
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa “impact faktor” si autor kryesor*		3
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa “impact faktor” si koautor**		
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të “proceedings” si autor kryesor ose si koautor		
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)		
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)		

Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor		
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja		
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	2	
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor		
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike -		

Mbështetur në Statutin e UPZ-së, Neni 173, pika 1.2 kandidati Labinot Berisha kriteret e parapara në Statut i plotëson relativisht mirë.

**Përvoja në mësimdhënie universitare**, mbështetur në dosjen dhe jetëshkrimin e kandidatit, i cili ka ofruar informacione se ka punuar në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë (01.10.2011-15.2.2012 dhe 01.10.2013-15.2.2014), periudhe e cila nuk mjafton me atë që kërkohet në Statutin e UPZ-së, Neni 173, pika 1.4 dhe 1.5.

Kandidati Labinot Berisha nuk i plotëson gjitha kushtet e parapara me Statutin e UPZ-së.  
**Refuzohet.**

#### IV. Të dhënat për kandidatin:

Emri dhe mbiemri: **Vehbi Miftari**

Datëlindja dhe vendlindja: 05. 05.1971 në Dumnice e Epërme.

Gradat shkencore: Studimet themelore i mbaroi në **Fakultetin e Filologjisë**, dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Prishtinë më 2002; **Magjistër i Shkencave të Filologjisë**, Prishtinë, 2005; **Doktor i Shkencave të Filologjisë**, 13. 03. 2009, Prishtinë.

Mbështetur në Statutin e UPZ-së, Nenin 173, pika 1.1, për këtë pikë kandidati i plotëson kriteret e parapara.

#### 1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit

Mbështetur në jetëshkrimin e kandidatit i përshkruajmë publikimet shkencore:

<b>Veprimtaria shkencore e kandidatit</b>	<b>Prej fillimit të karrierës</b>	<b>Gjatë 4 vjetëve të fundit</b>
Numri i publikimeve në revistat me “impact faktor” si autor kryesor*		
Numri i publikimeve në revistat me “impact faktor” si koautor**		
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa “impact faktor” si autor kryesor*	13	
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa “impact faktor” si koautor**		
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të “proceedings” si autor kryesor ose si koautor	5	
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	5	5
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	/	/
Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor		

Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja	/	/
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	11	9
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor		
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike -	12	

Kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 173, pika 1.2, kandidati i plotëson kushtet e parapara për pikën në fjalë. Publikimet e sistemuara në tabletën e prezantuar mund të jenë të lëvizshme, ato varen nga studimi dhe publikimi i tyre në revista të ndryshme me impakt apo pa impakt faktor. E rëndësishme është se këtë pikë të Statutit kandidati e ka plotësuar.

#### **Përvoja në mësimdhënie universitare**

Mbështetur në dosjen e kandidatit, i cili ka dëshmuar kënaqshëm se ka disa vite përvojë në mësimdhënie universitare. Kandidati i ka plotësuar kriteret e Statutit të UPZ-së, por mbështetur në vendimin e Rektorit të Universitetit “Ukshin Hotit” të Prizrenit nr.01.190, vendim i lëshuar nga prof.dr.Ramë Vataj – Rektor, të datës 01.06.2015, kandidati Vehbi Miftari ka qenë i angazhuar në Fakultetin e Filologjisë dhe me vetëdëshirë ka kërkuar për të mos e vazhduar punën në Universitetin e Prizrenit dhe në Fakultetin e Filologjisë. Dekanati dhe Rektori i UPZ-së e kanë miratuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të njëanshme nga ana e të kërkuarit, në këtë rast të z.Miftari. Komisioni recensues me një kujdes të shtuar e ka parë dosjen e kandidatit të z.Vehbi Mifarit, i cili në të vërtetë ka një jetëshkrim të pasur dhe mjaft premtues. Andaj, në kushtet e barabarta, Neni 8 i Statutit të UPZ-së shkruan “Universiteti siguron dhe mbështetë barazinë gjinore. Në rastet kur kandidatët e gjinisë mashkullore dhe femërore i kanë kualifikimet dhe te arriturat profesionale te barabarta, përparësi do t’i jepet kandidates femër”.

Neni në fjalë dhe përmbajtja e përshkrimit të përvojës së punës në Fakultetin e Filologjisë në Prizren mundësojnë objektivisht qëndrimin e komisionit recensues që të **mos e propozojnë**.

Kandidati nuk duhet të demotivohet sepse Fakulteti i Filologjisë në Prizren është në hapat e perspektives dhe të zgjerimit të stafit akademik dhe padyshim se kandidat z.Vehbi Miftari do ta nderon Fakultetin e Filologjisë në Prizren, po që se në konkurset e ardhshme do të pranohet. Për këtë konkurs z.Vehbi Miftari **nuk propozohet**.

**V. Të dhënat për kandidatin:**

Emri dhe mbiemri: Abedin Balaj

Datëlindja dhe vendlindja: 31.10.1958, Suharekë

Gradat shkencore: Studimet themelore i mbaroi në **Fakultetin e Filozofisë**, dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Prishtinë më 1985; **Master i Shkencave të Filologjisë**, Prishtinë, 2012.

Mbështetur në Statutin e UPZ-së, Nenin 173 dhe në dosjen e kandidati, i cili ka konkurruar për mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë në Prizren, Komisioni me keqardhje e informon kandidatin se nuk i plotëson kriteret e parapara në Statut. **Refuzohet.**

## PROPOZOJMË

Komisioni recensues mbështetur në të dhënat që u analizuan dhe prezantuan dhe duke u mbështetur në kriteret normative të parapara nga Universiteti, në harmoni me Statutin e Universitetit “Ukshin Hoti” të Prizrenit, në pajtim me dispozitat e neneve 8, 173,10; në harmoni me Ligjit e Punës nr. 03/L-212 dhe dispozitat e nenit 26 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Kosovës nr. 04/l-037 konstaton se kandidatja dr. sc. Vjollca Dibra **i plotëson kushtet** juridike dhe profesionale për t’u propozuar për profesor asistent.

Në pajtim me dispozitat e nenit 8 dhe 173 të Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe me kriteret e konkursit publik të datës 02. 08. 2016 të shpallur për personelin akademik kemi nderin dhe kënaqësinë që, Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Filologjisë dhe Universitetit të Prizrenit në Prizren t’i propozojmë kandidaten **dr. sc. Vjollca Dibra të zgjedhet profesor asistent** në Fakultetin e Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqipe, në lëndët: Hyrje ne shkencat e letërsisë; Teori e letërsisë; Letërsi për fëmijë; Letërsi popullore; Folklor arbëresh dhe kritikë letrare, sepse i plotëson të gjitha kushtet normative të parapara në konkursit publik.

### Nënshkrimet e Komisionit recensues:

1. Kryetar: Prof. dr. Enver Mehmeti 

2. Anëtar: Prof. dr. Mirlinda Kfirca 

3. Anëtar: Prof. dr. Shkelqim Millaku 

Prizren, më 06. 08. 2016

# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

## Fakulteti i Filologjisë, Prizren



### RAPORTI I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

**Lëndët:** Histori e letërsisë shqiptare I dhe II (Romantizëm); Letërsi krahasimtare; Historia e letërsisë shqipe (Realizëm).

**Kandidatët:** dr. sc. Teuta Vinca Kafexholli; dr. Besa Hoxha Beqir; dr.Labinot Berisha; dr.Vehbi Miftari; mr.sc.Abedin Balaj.

#### Komisioni recensues:

1. Kryetar: Prof. dr. Enver Mehmeti

2. Anëtar: Prof. dr. Mirlinda Krifca

3. Anëtar: Prof. asoc. dr. Shkelqim Millaku

Komisioni recensues ka kënaqësinë për të shkruar recension për staf të ri akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" të Prizrenit, përkatësisht për Fakultetin e Filologjisë. Komisioni do të mbështet në dispozitat e Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 04/L-037, Neni 26; Statutin e UPZ-së në përgjithësi (dhe në veçanti në nenet 8, 10, 173); në Ligjin e Punës nr. 03/L-212 dhe në dosjet apo jetëshkrimet e kandidateve.

### **Neni 173 i Statutit të UPZ-së ka këto kritere:**

1. Për titullin e profesorit asistent kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

1.1. të ketë gradën e doktorit të shkencës, (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të);

1.2. të ketë numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare si autor i parë ose korrespondent;

1.3. të ketë krijuar punime artistike ose të ketë pasur prezantime publike, kur është fjala për Fakultetin e Arteve;

1.4. të tregojë aftësi për mësimdhënie.

1.5. të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në procesin mësimor në Universitet.

2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit është për katër (4) vite.

### **Neni 8 i Statutit të UPZ-së ka këtë përmbajtje:**

Universiteti siguron dhe mbështetë barazinë gjinore. Në rastet kur kandidatët e gjinisë mashkullore dhe femërore i kanë kualifikimet dhe te arriturat profesionale te barabarta, përparësi do t'i jepet kandidates femër.

Ky raport shkruhet për titullin akademik: Profesor asistent (prof. ass.)

I. **Të dhënat për kandidaten:**

Emri dhe mbiemri: **Teuta Vinca - Kafexholli**

Datëlindja dhe vendlindja: 04.10.1963, Strugë

Gradat shkencore: Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë: Drejtimi - **Letërsi dhe gjuhë shqipe; Profesor**, nr. 9 (nota mesatare 8.56, në provimin e diplomës 9).

**Magjistër i Shkencave të Filologjisë**, Prishtinë, nr. 61.

**Doktor i Shkencave të Filologjisë**, nr. 3167.

Njohja dhe barasvlerësimi i gradës shkencore nga MASHT-i, nr. 6/3965.

**Kandidatja i plotëson kriteret e Statutit të Nenit 173, të pikës 1.1.**

**1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor për kandidaten**

**Tabela 1.**

<b>Veprimtaria shkencore e kandidatit</b>	<b>Prej fillimit të karrierës</b>	<b>të Gjatë 4 vjetëve të fundit</b>
Numri i publikimeve në revistat me “impact faktor” si autor kryesor*		
Numri i publikimeve në revistat me “impact faktor” si koautor**		
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa “impact faktor” si autor kryesor*	9	6
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa “impact faktor” si koautor**		
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të “proceedings” si autor kryesor ose si koautor		
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	7	6
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	8	6
Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor	5	4

Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja		
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	4	3
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor		
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike	7	2

<b>Të dhënat për punimet:</b>		
<b>Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet</b>		
<p>1. Një aspekt i poezisë së Mitrush Kutelit në plan krahasues, (MASHT, Java e shkencës, Libri i abstrakteve, 2015, f. 23, Prishtinë, ISBN 978-9951-16-090-2). (Punimi është në shtyp).</p> <p>2. Letëria në revistën Shejzat (Kumtese e lexuar në Institutin Albanologjik në Prishtinë 16-18 qershor 2014. Studimi përfshihet në “Albanologjia 5 ”vëllimin 5/I. Dëshmi: vërtetimi i lëshuar nga sekretari shkencor i IAP).</p> <p>3. Afërmimi i arsimit dhe i kulturës në një vepër të rëndësishme (MASHT, Java e shkencës, “Kumtesat I”, Shkencat gjuhësore, kulturore dhe historike, f. 699-703, 2014, Prishtinë, ISBN 978-9951-16-088-9).</p> <p>4. Kronotopi si nocion sipas studiuesve (MASHT, Java e shkencës, “Kumtesat I”, Shkencat gjuhësore, kulturore dhe historike, f. 630-634, 2013, Prishtinë).</p> <p>5. Koha, një fenomen i pranishëm në letërsi (studim, “Kosova sot”, 8.VI. 2013).</p> <p>6. Për Mitrush Kutelin dhe konstatimet e tij për këngët folklorike (MASHT, “Kumtesat”, nga Konferenca vjetore e shkencës, Java e shkencës, f. 315-320, 2012 , Prishtinë).</p> <p>7. Mitrush Kuteli si folklorist, IAP, “Gjurmime albanologjike”, seria e shkencave filologjike, 2010, 38-2008, faqe 292-311.</p>		

<p>8. Mitrush Kuteli poet, IAP, "Gjurmime albanologjike", Folklor dhe etnologji, 40-2010, 2009, faqe 325-340.</p> <p>9. Këngë e britma nga qyteti i djegur si vepër e parë në fushën e folklorit me kritere shkencore, botim i ASHAK, 1995, ("Bujku" 16. XII.)</p>		
<p><b>Të dhënat për punimet tjera:</b> <b>VEPRA TË BOTUARA:</b></p>		
<p><b>Kronotopi në prozën "E madhe është gjëma e mëkatit",</b> studim monografik me 194 faqe, Prishtinë, ISBN 978-9951-675-16-1.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Antologji e penave të reja</b> (me 181 f.), Prishtinë, ISBN 978-9951-8875-0-2.</li> <li>2. <b>Veleshtare moj...</b> (me parathënie dhe 132 këngë të llojeve të ndryshme, Strugë, ISBN 978-608-207-079-7.</li> <li>3. <b>Mitrush Kuteli si folklorist dhe poet,</b> studim monografik me 164 f., Strugë, ISBN 978-9989-114-89-7.</li> </ol>		
<p><b>TRAJNIMET/ ZHVILLIMI PROFESIONAL</b></p> <p>Anëtare në komisione të mbrojtjeve të temave të masterit (Kolegji AAB), 2015.</p> <p>Certifikatë për pjesëmarrje me kumtesë; Java e Albanologjisë, 2014</p> <p>Award of excellence - For outstanding contribution to the success of ASK, 2013.</p> <p>For completion of professional development, 2013.</p> <p>Certificate of participation in the workshop on the 4 pillars of literacy, 2009.</p> <p>Certificate: Participant of the learner centered Instruction program (Educationv Development Association), 2008.</p> <p>Certificate of attendance: Has successfully attended training on GOING ONLINE, 2006.</p>		

**Kandidatja i plotëson kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 173, të pikës 1.2.**

## 2. Përvoja në mësimdhënie universitare

Kandidatja Teuta Vinca Kafexholli ka një përvojë të gjatë në mësimdhënie, si:

UNIVERSITETI I PRIZRENIT- FAKULTETI I FILOLOGJISË nga tetor 2014 dhe vazhdon edhe sot si ligjëruese e **angazhuar** në lëndët: Kulturë dhe qytetërim shqiptar; Teori e letërsisë; Historia e letërsisë shqipe I – Romantizmi; Hyrje në shkencën e letërsisë.

**Kandidatja Teuta Vinca - Kafexholli në Fakultetin e Filologjisë në Prizren ka treguar kujdes të shtuar në mësimdhënie, e pranueshme nga kolektivisht dhe e vlerësuar pozitivisht nga studentët, mirëpo edhe mbështetëse në gjitha kërkesat e njësisë akademike.**

Tetor 2015 - UNIVERSITETI AAB: Ligjëruese në lëndët: Morfologji dhe ortografi e gjuhës shqipe, Gjuhë amtare, Sintaksë e gjuhës shqipe, Komunikim biznesi (niveli master).

Tetor 2013 – 2015 KOLEGJI I MENAXHMENTIT INTERNACIONAL “GLOBUS”- PRISHTINË, Ligjëruese në lëndën (me angazhim): Shkrim akademik - Shkathtësi në shkrimin e raporteve profesionale.

Tetor 2012- 2013 UNIVERSITETI I PRISHTINËS- FAKULTETI I EDUKIMIT – PRISHTINË Ligjëruese në lëndën (me angazhim), Shkrim akademik.

Shkurt 2012 – vazhdon UNIVERSITETI I PRISHTINËS – FAKULTETI EKONOMIK- PRISHTINË Ligjëruese në lëndën (me angazhim): Kulturë gjuhe dhe shkrim akademik.

Tetor 2009 – Shtator 2013 KOLEGJI VICTORY Ligjëruese në lëndët (me angazhim): Shkrim akademik 1, Shkrim akademik 2, Shkrim biznesi

Shtator 2008 – 2013 Profesor UNITED WORLD COLLEGE – MOSTAR-SINGAPUR Profesor në distancë - (Self Taught Albanian A Generation).

Shtator 2004 – 2014 Profesor AMERICAN SCHOOL OF KOSOVA - PRISHTINË

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Shtator 2003 – 2004 Profesor SHKOLLA E MESME “SAMI FRASHËRI” - PRISHTINË

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi.

Shtator 1999 – 2003 Profesor SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË “ALI SOKOLI” – PRISHTINË. Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi.

**Kandidatja i plotëson kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 173, të pikës 1.4 dhe 1.5.**

### **3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim**

Kandidatja dr.sc. Teuta Vinca Kafexholli ka qenë dhe është pjesëmarrëse në shumë simpoziume shkencore, trajnime, seminare kulturore, organizime të përvjetorëve të shkrimtarëve të njohur etj.

Ka marrë pjesë në komisione për pranimin e studentëve në Universitetin e Prizrenit, Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Gjithashtu ka qenë pjesë e komisioneve të mbrojtjes së temave të masterit në Kolegjin AAB.

Qysh herët është marrë me mbledhjen e folklorit në trevat e Strugës dhe treva të tjera folkorike, duke u bërë kështu bashkëpunëtorë e jashtëmë e Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Ka marrë pjesë në simpoziumet shkencore të organizuara nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës nga viti 1995. Gjithashtu ka marrë pjesë edhe në konferencat shkencore të organizuara nga MASHT-i, Instituti Albanologjik, punime të cilat janë botuar në revistat shkencore të “Gjurmimet Albanologjike” dhe në botimet e publikimet të MASHT-it. Ka kryer një varg trajnimesh dhe ka mirënjohje në fusha të ndryshme. Gjithashtu ka një përvojë të gjatë dhe mjaft të suksesshme në mësimdhënie.

Kandidatja ka marrë pjesë në konferencat shkencore të organizuara nga Fakulteti i Filologjisë në Prizren, punimet e të cilës janë publikuar dhe janë në proces të publikimit.

Kandidatja ka botuar këto vepra me interes të fushës profesionale: Monografinë “Mitrush Kuteli si folklorist dhe poet”, Strugë, 2008. Për veprën e cituar kanë shkruar disa studiues, ndër të cilët duhet përmendur dr.sc. Dhimitër Gegprifti në punimin e tij “Sintezë vlerash të një personaliteti me përmasa jo të zakonshme” botuar në “Zëri” Prishtinë 15.11. 2008.

Vepra me titull “Veleshtare moj...”, me parathënie dhe me 132 këngë të llojeve të ndryshme, botuar në Strugë, 2012.

“Antologji e penave të reja”, Prishtinë, 2013. Eseistike të talenteve të rinj. Një vepër nga puna e saj me një përvojë të gjatë pedagogjike.

Studimin monografik “Kronotopi në prozën “E madhe është gjëma e mëkatit”, botim nga Ministria e Kulturës, Prishtinë, 2014.

#### **4. Mobiliteti i kandidatës**

Kandidatja dr.sc. Teuta Kafexholli studimet themelore i ka kryer në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë me notë mesatare 8.58 (punimin i diplomës, nota 9). Po aty mbron edhe temën e magjistraturës me një sukses të dalluar. Disertacionin e ka mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë “Bllazhe Koneski”: të Universitetit “Shën Cirili e Metodi” të Shkupit, duke bërë një studim shkencor të mirëfilltë.

Qysh herët është marrë me mbledhjen e folklorit në trevat e Strugës dhe treva të tjera folklorike, duke u bërë kështu bashkëpunëtoare e jashtme e Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Kandidatja ka konkurruar për dy pozitat e shpallura në konkursin.

**Kontributi i saj disa vjeçar në mësimdhënie parauniversitare dhe universitare ka dëshmuar se kandidatja ka talent të lindur për artin e mësimdhënies. Në Fakultetin e Filologjisë në Prizren, për kandidaten kemi vetëm fjalë miradije dhe premtuese se do të jep kontributin e saj modest.**

**Kandidatja Teuta Vinca-Kafexholli i plotëson të gjitha kriteret e Statutit të UPZ-së për t’u propozuar për profesor asistent.**

## **II. Të dhënat për kandidaten**

Emri dhe mbiemri: **Besa Hoxha Beqiri**

Datëlindja dhe vendlindja: 04.02.1968, Shkup.

Gradat shkencore: Studimet themelore i mbaroi në **Fakultetin e Filologjisë**, dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Prishtinë, në vitin 1990 (nr.287); **Magjistër i Shkencave të Filologjisë**, Prishtinë, 1995; Studimet e doktoraturës i mbaron në Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë dhe ka fituar gradën shkencore – Doktor në Studime Letrare, 2015, nr.4. Njohja dhe barasvlerësimi i gradës shkencore nga MASHT-i nr.6 -1828.

Kandidatja ka doktoruar në Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë, mirëpo mbështetur në Statutin e Qendrës në fjalë, Neni 71 shkruan: “Programet e studimeve doktrate janë programe studimesh të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë **kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur**” dhe Neni 76 “...autorizohet të kryejë mësimdhënie edhe jashtë QSA, për një ngarkesë deri në 30% të ngarkesës së pedagogut me post dhe gradë shkencore ekuivalente”.

Fakulteti i Filologjisë në Prizren ka shpallur konkurs për mësimdhënës dhe nuk ka kërkuar hulumtues shkencore, prandaj kandidatja nuk e plotëson kriteret e Nenin 173, pikën 1.1 të Statutit të UPZ-së.

Mbështetur në jetëshkrimin e kandidates, e cila dëshmon se ka disa studime të botuar, si: Një histori letërsie e ndaluar – Si u përjashtuar Fishta, Konica dhe Skiroi nga Historia e letërsisë shqipe ..., Tiranë, 2016; Eshtrat e ringjalljes, Rozafa Prishtinë, 2016; Kumtesa të ndryshme: Një histori letërsie e pabotuar, Prizren, 2014; The Albanian Literature in internet, Shkodër, 2014 dhe studime të tjera. Kushtet e Statutit të UPZ-së, Nenit 173, pikën 1.2 kandidatja relativisht mirë i ka plotësuar.

Statuti i Universitetit të Prizrenit, Neni 173, pika 1.4 dhe 1.5, i cili kërkon përvojën e punës universitare, nga dosja e kandidates Besa Hoxha-Beqiri nuk ka dëshmuar dhe dëshmi se ka përvojë në mësimdhënien universitare.

Kandidatja Besa Hoxha Beriqi nuk i plotëson gjitha kushtet e parapara me Statut. **Refuzohet.**

### III. Të dhënat për kandidatin

Emri dhe mbiemri: **Labinot Berisha**

Datëlindja dhe vendlindja: 30.11.1969

